



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.  
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.  
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Prishtina,  
Kosovo

Tel: 038/226-070, 225-006, Fax: 038/226-159; Email: iber\_lepenci@hotmail.com

---

**RREGULLORE PËR PËRDORIMIN E AUTOMJETEVE  
ZYRTARE  
NË "N.H IBËR LEPENC"**

**PRISHTINË, MAJ 2010**

# RREGULLORE PËR PËRDORIMIN E AUTOMJETEVE ZYRTARE

## Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të rregullojë të drejtën e përdorimit të rregullt dhe efikas të të gjitha automjeteve të ndërmarrjes.

## Neni 2 E drejta e përdorimit të automjeteve zyrtare

- (1) Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes ka të drejtë të përdorë veturën zyrtare 24 orë në ditë, për qëllime zyrtare.
- (2) Punëtorët e tjerë të ndërmarrjes kanë të drejtë që vetëm gjatë orarit të punës, për nevoja zyrtare të përdorin automjetet zyrtare.
- (3) Përdorimi i automjetit zyrtar jashtë orarit zyrtar nga udhëheqësit dhe punëtorët tjerë, me qëllim të realizimit efikas të detyrave të punës është i mundur me lejin nga Kryeshefi Ekzekutiv.
- (4) Veturat e terrenit përdoren ekskluzivisht për nevojat e Ndërmarrjes dhe vetëm në bazë të lejes së udhëheqëseve të njësive në terren, të cilat nënshkruan urdhër udhëtimet për çdo kërkesë për shfrytëzim.
- (5) Urdhër udhëtimet me kilometrat e shpenzuara i dërgohen zyrtarit për transport.
- (6) Për çdo keqpërdorim të veturës zyrtare nga punëtorët e Ndërmarrjes, përveç keqpërdoruesit, për paarsyeshmerinë e dhënies së lejes për shfrytëzim përgjigjet edhe udhëheqësi përkatës.

## Neni 3 Përdorimi i automjeteve zyrtare

- (1) Automjetet zyrtare shërbejnë për kryerjen e detyrave zyrtare dhe përdoruesit e tyre duhet t'i shfrytëzojnë ato, në mënyrë ekonomike dhe me qëllim të efikasitetit në punë.
- (2) Automjetet e ndërmarrjes mund të përdoren për udhëtime zyrtare edhe jashtë vendit me lejen e Kryeshefit Ekzekutiv.



- (3) Përveç emblemës së Ndërmarrjes automjeti zyrtar i Ndërmarrjes nuk mund të ketë asnjë shenjë tjetër.
- (4) Për shkeljet e rregullave në komunikacion me fajin e tij përgjegjësinë e bart shfrytëzuesi i automjetit zyrtar.

#### **Neni 4** **Mirëmbajtja dhe servisimi**

- (1) Drejtuesi i automjetit zyrtar është përgjegjës për mirëmbajtjen e tij, për këtë qëllim çdo drejtues bënë kontrollin ditor / javor të automjetit.
- (2) Drejtuesit e automjetit zyrtar janë përgjegjës edhe për sigurinë e automjeteve brenda dhe jashtë. Është përgjegjësi e tyre të sigurojnë që automjetet zyrtare të jenë parkuar siç duhet dhe të mos rrezikohet nga vjedhësit, aksidentet, vandalizmi apo ndonjë rrezik tjetër i mundshëm.
- (3) Servisimet e lehta te automjeteve bëhen në punëtorinë e Ndërmarrjes.
- (4) Në rast se defektet janë më serioze atëherë servisimi bëhet vetëm në servis in e zgjedhur nga ndërmarrja, sipas rregullave të prokurimit të zbatuara në Kosovë.
- (5) Me rastin e marrjes së automjetit zyrtar nga servisimi punëtore kompetent i Ndërmarrjes, është përgjegjës për të verifikuar se a janë evituar prishjet për të cilat automjeti zyrtar është servisuar.

#### **Neni 5** **Parkimi i automjeteve zyrtare**

Të gjitha automjetet zyrtare, përveç automjetit të Kryeshefit Ekzekutiv, pas përfundimit të orarit duhet të parkohen dhe qëndrojnë në parkingun e ndërmarrjes apo edhe në njësitë punuese në terren.

#### **Neni 6** **Përgjegjësinë për zbatim**

Përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje janë të gjithë shfrytëzuesit e veturave zyrtare të Ndërmarrjes, ndërsa Kryeshefi Ekzekutiv përcjell zbatimin e saj.



**Neni 7**  
**Hyrja ne fuqi**

Kjo Rregullore do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryeshefi Ekzekutiv të Ndërmarrjes.

**31.05.2010**

**Kryeshef Ekzekutiv**  
**Hajdar Beqa**  
  
